



# RAPORTI I ARRITJEVE IZHA

Shtator 2013 – Dhjetor 2016

Rr. Naim Frashëri,  
Nr. 37, Tiranë, Shqipëri.  
+355 4 256 441  
sekretaria@izha.edu.al  
www.izha.edu.al





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

---

# RAPORTI I ARRITJEVE IZHA

SHTATOR 2013 – DHJETOR 2016

Rr. Naim Frashëri,  
Nr. 37, Tiranë, Shqipëri.

+355 4 256 441

sekretaria@izha.edu.al  
www.izha.edu.al

## Tabela e Përmbajtjes

Parathënie.....	4
Hyrje.....	5
1. Reformimi i kurrikulës .....	6
1.1 Reformimi i paketës kurrikulare të arsimit parauniversitar .....	6
1.2 Pilotimi i kurrikulës së re .....	9
1.3 Finalizimi i programeve të klasave përgatitore, I, II, III, VI, VII, VIII. ....	10
1.4 Përgatitja e planeve mësimore dhe programeve lëndore për shkollat me drejtim të orientuar .....	11
1.5 Përgatitja e planeve mësimore për shkolla të veçanta.....	11
1.6 Hartimi i programeve lëndore për shkolla, institucione dhe qëllime të veçanta .....	11
1.7 Detyra të veçanta.....	12
2. Zhvillimi profesional i mësuesve .....	13
2.1 Trajnimi i mësuesve .....	13
2.2 Kualifikimi i mësuesve.....	14
2.3 Akreditimi i programeve dhe i moduleve të trajnimit.....	15
2.4 Vlerësimi kombëtar i mësuesve për identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional .....	15
3. Testimi kombëtar “Mësues për Shqipërinë” .....	17
4. Hartimi i standardeve sipas profileve lëndore për mësuesit.....	17
5. Organizimi i trajnimit të drejtuesve sipas programit të zhvillimit profesional dhe kualifikimit të drejtuesve. (në proces).....	18
6. Përmirësimi i skemës së zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë .....	18
II. Teknologjia në mësimdhënie .....	19
III. Politikat arsimore .....	21
3.1 Vlerësimi i kurrikulës së formimit të mësuesve në institucionet e arsimit të lartë përballë reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar. ....	21

3.2 Identifikimi dhe hartimi i kompetencave profesionale të mësuesve fillestarë që përgatiten nga institucionet e arsimit të lartë; .....	21
3.3 Ofrimi i materialeve/moduleve për institucionet që përgatisin mësues lidhur me konceptet bazë dhe risitë e reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar .....	22
IV. Rritja e lidhjeve të shkollës me komunitetin – shkolla si qendër komunitare(SHQK)	22
V. Diaspora .....	24
5.1 Përgatitja e kurrikulës së mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës në diasporë në bashkëpunim me MAS dhe MASHT .....	24
5.2 Organizimi dhe mbështetja e organizimit të seminarit të përvitshëm me mësues nga diaspora .....	25
5.3 Përgatitja e modeleve të veprimtarive mësimore në ndihmë të mësuesve në diasporë	25
VI. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe asistenca teknike .....	26
6.1 Rritja e partneritetit në vendimmarrje për çështje të arsimit .....	26
6.2 Asistenca teknike pranë MAS-it .....	27
6.3 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera.....	28
7. Konferenca .....	30
8. Studime shkencore dhe botime .....	31

## **Parathënie**

Instituti i Zhvillimit të Arsimit, (më poshtë IZHA), është institucion i krijuar në mars të vitit 2010 si institucion publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, mbi bazën e Institutit të Kurrikulave dhe Trajnimit.

Historiku i këtij institucioni, me attribute ekspertimi, këshillimi dhe studimi në arsim, nis shumë më herët, që nga viti 1965, kohë kur instituti u emërtua si Instituti i Studimeve Pedagogjike.

IZHA është person juridik publik, në varësi të Ministrit të Arsimit dhe Sportit me seli në rrugën “Naim Frashëri”, nr.37, Tiranë.

IZHA është anëtare me të drejta të plota e disa rrjeteve ndërkombëtare si CIDREE (Consortium of Institutions for Development and Research in Education in Europe) dhe Global Education. Ajo ka disa detyra dhe përgjegjësi në rrjete, si pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta dhe ndjekjen e takimeve dhe konferencave të përvitshme, ku raporton për zhvillimet akademike të arsimit para-universitar në Shqipëri.

### ***Misioni dhe objekti i veprimtarisë së IZHA***

- IZHA i ofron Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe institucioneve arsimore në vend ekspertizë dhe këshillim me nivel të lartë profesional, mbështetur në rezultatet e punës kërkimore-shkencore dhe praktikës arsimore.
- IZHA ka për objekt të veprimtarisë së saj hartimin e kurrikulës për sistemin arsimor parauniversitar, zhvillimin e politikave të arsimit parauniversitar dhe atij të lartë, përgatitjen e dokumenteve të ndryshme në lidhje me politikat kombëtare në fushën e arsimit dhe kryerjen e punëve kërkimore studimore në fushat e didaktikës dhe përdorimit të teknologjive moderne në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Veprimtaritë e planifikuara dhe të realizuara nga IZHA për periudhën shtator 2013 – dhjetor 2016 kanë pasur dhe kanë për qëllim ofrimin e zgjidhjeve afatshkurtra e afatgjata në fusha e aspekte të ndryshme të arsimit. Ato burojnë nga projekte të nxitura nga Strategjia e Arsimit Parauniversitar, përparësitë e politikës arsimore të qeverisë dhe nevojat e realitetit arsimor shqiptar.

## Hyrje

Në shtatorin e vitit 2013, MAS-i nisi një reformë të thellë në sistemin arsimor parauniversitar shqiptar e cila pritet të ketë shtrirje kohore disavjeçare. IZHA është një nga aktorët kryesorë në varësi të MAS-it e cila luan një rol thelbësor në hartimin dhe implementimin e kësaj reforme.

Politika arsimore e Qeverisë Shqiptare, e shpallur në programin e saj, vë theksin në zhvillimin e një arsimit që t'i shërbejë **interesit më të mirë të nxënësit, të sigurojë arsimim cilësor dhe të barabartë për çdo pjesëtar të shoqërisë**, pavarësisht nga përkatësia etnike, seksi, pozita shoqërore dhe ndryshime të tjera.

Duke u bazuar në parimin “Cilësi dhe barazi në arsim” kjo politikë synon:

- të rritë cilësinë e arsimit në të gjithë përbërësit e tij sasiorë dhe cilësorë;
- të krijojë, *në maksimumin e vet të mundshëm*, kushtet që garantojnë barazinë e shërbimit arsimor për çdo nxënësi.

### **Ky raport sintetik pasqyron:**

- **së pari**, çfarë është arritur në një periudhë, gati tre vjeçare, në fushat kryesore të reformës;
- **së dyti**, çfarë është konsoliduar, si bazë, për të garantuar zhvillimet e parashikuara në plan afatgjatë dhe për të shkuar më tej drejt realizimit të objektivave të reformës.

Reforma aktuale në arsimin parauniversitar është projektuar të zbatohet në disa fusha kryesore:

- Reformimi i kurrikulës.
- Zhvillimi profesional i mësuesve.
- Rritja e lidhjeve të shkollës me komunitetin.
- Rritja e partneritetit në vendimmarrje për çështje të arsimit, si çështje e të gjithë shoqërisë.
- Rritja e partneritetit dhe e bashkëpunimit me institucione e organizma të tjerë qeveritarë dhe jo qeveritarë, të brendshëm e të huaj, në funksion të realizimit të objektivave të politikës dhe të reformës arsimore.

## 1. Reformimi i kurrikulës

Reformimi i kurrikulës synon të ofrojë rezultatet e të nxënimit në shkollë, me vlerën e tyre praktike në kontekstin ekonomik, shoqëror dhe kulturor në Shqipëri, me qëllim që të rritet vlera e shkollës për nxënësin dhe interesat e tij. Për këtë arsye, në themel të politikës së arsimit parauniversitar, në fushën e kurrikulës, u vendos si përparësi aftësimi i nxënësve me njohuritë, aftësitë, qëndrimet që do ta ndihmojnë atë të përballojë jo vetëm sfidat e arsimit të tij të mëtejshëm ose të jetës e të punësimit sot, por në mënyrë të veçantë, të përballojë sfidat e së ardhmes.

Kjo kërkon nga arsimi që nxënësve t'u krijohej mundësia të njohin dhe të kuptojnë ligjësitë e botës, të natyrës dhe të shoqërisë, por edhe të aftësohen të marrin, në çdo kohë, vendimet e duhura për interesat vetjake e të shoqërisë ku jetojnë.

Për këtë arsye, *reforma kurrikulare ka në themel të saj pikërisht aftësimin e nxënësit për jetën dhe për të nxënëit gjatë gjithë jetës, që përputhet edhe me Rekomandimin e Parlamentit dhe të Këshillit të Evropës për kompetencat themelore për të nxënëit gjatë gjithë jetës.*

Në zbatim të kësaj politike, gjatë periudhës 2013 – 2016, janë zhvilluar veprimtaritë e mëposhtme:

### 1.1 Reformimi i paketës kurrikulare të arsimit parauniversitar

Në këtë paketë bëjnë pjesë:

- **Korniza e re kurrikulare e arsimit parauniversitar**, miratuar nga MAS në qershor të vitit 2014.

*Së pari*, korniza kurrikulare është hartuar në kuadër të reformës, ka si bosht qendror kompetencat themelore të të nxënëit gjatë gjithë jetës, të përkufizuara e të shoqëruara me treguesit përkatës në të.

*Së dyti*, korniza është produkt i harmonizimit të politikës arsimore të Shqipërisë dhe të politikës arsimore të Kosovës (referuar Marrëveshjes së Unifikimit të Kornizës midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, Qershor 2014) . Përgatitja e këtij dokumenti kaloi përmes një faze të gjerë diskutimesh me DAR/ZA, drejtues dhe

specialistë të arsimit, përfaqësues të universiteteve, mësues, prindër dhe palë të tjera të interesit.

- **Plani mësimor i arsimit bazë.** Plani mësimor është produkt i një pune të gjerë kërkimore, studimore, krahasuese, konsultuese i specialistëve të IZHA-s dhe MAS-it, i grupeve të gjera lëndore dhe i grupeve të tjera të interesuar për këtë qëllim.

- **Kurrikula bërthamë** për:

*a)* klasën përgatitore dhe arsimin fillor (klasat I-V);

*b)* arsimin e mesëm të ulët (klasat VI-IX)

dhe

*c)* për arsimin e mesëm të lartë (klasat X-XII).

Ky dokument i parapriu hartimit të dokumenteve të tjerë të paketës kurrikulare si: programet lëndore, udhëzuesit kurrikularë etj., të cilat janë në themel të procesit mësimor të të nxënësve dhe mësimdhënies.

- **Programet lëndore të arsimit bazë.** Në kuadër të reformës janë hartuar programet lëndore për arsimin bazë K-9.

➤ Programet e **klasave të para dhe të gjashta**, pasi kaluan në procesin e pilotimit përgjatë vitit shkollor 2014-2015, u miratuan nga MAS dhe **shërbyen si bazë për hartimin e teksteve të reja dhe për trajnimin e mësuesve të klasave të para dhe të gjashta në të gjithë vendin (shih më poshtë).**

➤ **Programet e klasës II dhe VII.** Pasi u analizuan dhe përpunuan rezultatet e pilotimit të kurrikulës së klasave të dyta dhe të shtata, të mbledhura përmes takimeve periodike me mësuesit në pilotim, vëzhgimeve, pyetësorëve dhe trajnimeve, u identifikuan çështjet e programeve për rishikim, u bërë përmirësimet e sugjeruara në program, u hartuan draftet përfundimtare të tyre për miratim, fillimisht nga një tryezë e zgjeruar dhe më pas nga MAS-i. Pas miratimit këto programe u vunë në zbatim në gjithë Shqipërinë.

➤ **Programet e klasave të treta dhe të teta.** Me të njëjtën metodikë u punua dhe me programet e **klasës III ( 9 programe) dhe VIII ( 14 programe)**, të cilat tashmë janë të miratuara, pasi ishin përgatitur më parë në dritën e përfundimeve të përgjithshme të pilotimit të kurrikulës së klasës I,II,VI,VII, në lidhje me kërkesat e përdoruesve të tij.

**Këtë vit shkollor po vazhdon pilotimi i kurrikulës së klasës III dhe VIII.**

- **Korniza e vlerësimit,** që përcakton politikën dhe parimet themelore të vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe sistemit arsimor e do të shërbejë për marrjen e vendimeve sa më të drejta për përmirësimin e rezultateve të të nxënësve dhe të vetë procesit të tij.



- **Hartimi i standardeve të vlerësimit të nxënësit** që është një ndër objektivat nga më të rëndësishëm të reformës arsimore të arsimit parauniversitar, sepse vlerësimi kushtëzon të gjithë procesin e mësimdhënies dhe lidhet drejtpërdrejt me rezultatet individuale të secilit nxënës dhe me rezultatet e arsimit në përgjithësi.

**Për këtë qëllim janë kryer veprimtaritë e mëposhtme:**

- janë studiuar përvoja të shumta botërore në fushën e vlerësimit, të parimeve, kriterëve dhe të standardizimit të tyre. Nga ana tjetër u studiuua me kujdes përvoja ekzistuese në vendin tonë në fushën e standardeve të vlerësimit
- u përcaktua parimi referues i hartimit të standardeve të arritjeve të nxënësit që është ai i kriterit standard;
- u përcaktuan nivelet e arritjeve të nxënësit (dobët, mjaftueshëm, mirë dhe shumë mirë);
- u hartuan standardet e vlerësimit të nxënësit sipas lëndëve;

**Në arsimin e mesëm të lartë kryem një reformë Reformë moderne në kurrikulat e gjimnazit / lehtësuam ngarkesën nga 18 lëndë vetëm 13 lëndë në vit**

- **Hartuam planin e ri mësimor të gjimnazit**, që i shërben vijueshmërisë së reformës në të gjithë arsimin parauniversitar. Lehtësuam ngarkesën nga 18 lëndë vetëm 13 lëndë në vit. Klasa e 12 do të ketë vetëm 5 lëndë të detyrueshme, të tjerat do të zgjidhen sipas nevojës së çdo maturanti, bazuar në kriteret që do të përcaktojnë IAL.
- **Hartuam programet për klasën X dhe XI të gjimnazit për kurrikulën bërthamë ( 10 programe) dhe atë me zgjedhje ( 4 programe) .**
- **Hartuam programeve të lëndëve ose moduleve me zgjedhje për gjimnazin.**
- **Hartuam udhëzimin për vlerësimin në AML.**
- **Hartuam udhëzimin udhëzuesin për portofolin e nxënësit.**

Në arsimin parashkollor, u hartuan:

- **Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor**, e cila ka statusin e dokumentit politik, me fuqi gjithëkombëtare. Ajo rrjedh dhe përmbush frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe përmbajtjen e Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Korniza kurrikulare e arsimit parashkollor është në rezonancë të plotë me kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar.
- **Standardet e zhvillimit dhe të nxënësve të fëmijëve 3-6 vjeç**, të cilat i referohen moshës së fëmijëve nga 3-6 vjeç. Këto standarde përshkruajnë sjelljet, aftësitë dhe

njohuritë që duhet të kenë ose të jenë të aftë t'i tregojnë fëmijët e kësaj grupmoshe. Standardet përcaktojnë çfarë mund dhe janë në gjendje të bëjnë, të thonë dhe të demonstrojnë fëmijët gjatë rritjes, zhvillimit dhe kalimit nga njëra grupmoshë në tjetrën.

- **Programet e reja të arsimit parashkollor të moshës 3-6 vjeç (draft).** Programet e reja janë ndërtuar mbi bazën e fushave të të nxënimit dhe mbajnë parasysh treguesit e standardeve të zhvillimit të të nxënimit të fëmijëve 3-6 vjeç. Struktura dhe përmbajtja e programeve të reja është në të njëjtën linjë me programet e arsimit të detyruar, por metodologjia është përshtatur për specifikat e punës me fëmijët në këtë nivel edukimi.
- Në vitin shkollor 2016-2017, janë në proces pilotimi programet për grup-moshën 3-4 vjeç.

## **1.2 Pilotimi i kurrikulës së re**

Kjo është një risi e politikës së hartimit të kurrikulës në 2-3 dekadat e fundit.

Gjatë viteve shkollore **2014-2015 dhe 2015-2016** u pilotuan programet e klasave përgatitore, klasave të para, të dyta, të gjashta dhe të shtata, në 26 shkolla të vendit. Për vitin shkollor 2016 – 2017 vazhdon pilotimi po në 26 shkolla për kurrikulat e klasave të treta dhe të teta. Ky proces, përveçse i shërbeu testimit të draftprogrameve të këtyre klasave, rriti edhe pjesëmarrjen e mësuesve, deri në partneritet, në procesin e përmirësimit të tyre. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrja në pilotim, u dha mësuesve shansin që:

**a)** të ndihen bashkautorë të programeve;

**b)** të trajnohen për zbatimin më të mirë të tyre në praktikë.

Procesi i pilotimit shërbeu për sensibilizimin e opinionit publik dhe të interesuarve për thelbin e reformës si edhe për hedhjen e bazave të përfshirjes graduale të prindërve në procesin e vendimmarrjes për çështjet arsimore në interes të përbashkët.

Puna e bërë *gjatë dhe për qëllime* të pilotimit të realizuar gjatë periudhës 2014 – 2015 dhe 2015- 2016 përfshiu:

- përcaktimin e **kritereve** për drejtorët e shkollave, mësuesit e përfshirë në pilotim, koordinatorët e shkollave pilot, koordinatorët e fushave kurrikulare, koordinatorët në nivel DAR/ZA-je, koordinatorët në nivel MAS-i dhe ISHA;
- përcaktimin e **kritereve** për përzgjedhjen e shkollave pilot në të cilat do të realizohej procesi i pilotimit dhe përzgjedhja e tyre. 26 shkolla të arsimit të mesëm të ulët (13 në qytet dhe 13 në fshat), në të cilat u përfshinë dhe vazhdojnë të përfshihen :
  - ✓ 26 klasa parapërgatitore (13 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa të para (26 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa dyta (26 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa të treta (26 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa të gjashta (26 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa të shtata (26 qytet dhe 13 fshat);
  - ✓ 39 klasa të teta (26 qytet dhe 13 fshat).
- organizimin e **seancave informuese** në median e shkruar dhe elektronike për kurrikulën e re, **54 seanca informimi** me prindërit dhe aktorë të tjerë në shkollë, prezantime etj.;
- përgatitjen e **materialeve trajnuese** për mësuesit e shkollave pilot për zbatimin e programeve lëndore, planifikimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e nxënësve në kuadër të pilotimit (**19 module trajnimi**).
- **ngritjen e kapaciteteve** të DAR-ve, drejtuesve dhe mësuesve të shkollave pilot për procesin e pilotimit. Rreth **480 mësues** të 26 shkollave pilot u trajnuan për secilin vit nga specialistët e IZHA-s në lidhje me kurrikulën e re dhe ky grup krijoi rrjetin të trajnerëve;
- **monitorimin e procesit të pilotimit përmes** vëzhgimeve periodike të përmuajshme, konsultimeve, takimeve, komunikimeve online dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet shkollave;
- **vlerësimin e procesit të pilotimit** për përmirësimin e paketës kurrikulare, proces i cili përfshiu hartimin dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit, vëzhgime të drejtpërdrejta të procesit mësimor, studimin/analizën e të dhënave të pilotimit të kurrikulës në klasat përgatitore, të para dhe të gjashta dhe përgatitjen e raportit përmbledhës me gjetjet kryesore të tij.

### 1.3 Finalizimi i programeve të klasave përgatitore, I,II,III,VI,VII,VIII

U përmirësuan dhe u finalizuan **69 programet** e klasave përgatitore, klasave të para , të dyta, të treta, të gjashta , të shtata dhe të teta duke u bazuar në gjetjet dhe përfundimet e procesit të pilotimit.

#### **1.4 Përgatitja e planeve mësimore dhe programeve lëndore për shkollat me drejtim të orientuar :**

Gjithsej **99 programe** nga të cilat:

##### **a) artistike , dega muzikë 41 programe :**

- arsimi i mesëm i ulët **9 programe** lëndore artistike;
- arsimi i mesëm i lartë **32 programe**.

##### **b) artistike, dega koreografi 19 programe :**

- arsimi i mesëm i ulët **8 programe** lëndore artistike;
- arsimi i mesëm i lartë **11 programe**.

##### **c) artistike , dega art figurativ, arsimi i mesëm i lartë 12 programe:**

**d) Sportive 24 programe :** për arsimin e mesëm të lartë , shkollat “ **Loro Boriçi**” dhe “ **Bernandina Qeraxhia**” .

##### **e) Gjuhë të huaja 3 programe**

#### **1.5 Përgatitja e planeve mësimore për shkolla të veçanta**

- Plani mësimor për klasat e shansit të dytë.
- Plani mësimor për fëmijët e ngjuar.
- Plani mësimor për shkollat speciale.
- Plani mësimor për institucionet e paraburgimit.
- Plani mësimor për arsimin bazë me kohë të pjesshme.

#### **1.6 Hartimi i programeve lëndore për shkolla, institucione dhe qëllime të veçanta**

- **37 programe lëndore** për fëmijët e ngjuar (klasat I – V, VI - IX) dhe për klasat e shansit të dytë (klasat I – V, VI – IX).
- Rreth **90 programe** për arsimin bazë me kohë të pjesshme.
- Rreth **90 programe** për institucionet e paraburgimit.
- **12 programe** të rishikuara dhe të plota për lëndën e edukimit fizik, për arsye të rritjes së numrit të orëve të kësaj lënde në planin mësimor.
- **33 programe për pakicat kombëtare** (greke dhe maqedonase).

- **12 programe** të lëndëve të përgjithshme të shkollave të arsimit profesional.
- Janë hartuar **12 module profesionale** dhe **4 module lëndore** .
- **39 programe orientuese** për maturën shtetërore **për vitin 2013** dhe **39 programe** për secilin nga vitet **2014 , 2015 dhe 2016**.

### 1.7 Detyra të veçanta

Gjatë vitit 2016, me nismën e Kryeministrit Rama, për integrimin në kurrikulën e shkollës të njohurive për fenë dhe çështjet që lidhen me të, në kuadrin e edukimit ndërkulturor dhe qytetar, u kryen veprimtaritë e mëposhtme:

- U hartua draft programi për integrimin e njohurive për fenë dhe të çështjeve që lidhen me të në kurrikulën e lëndës Qytetaria, për klasën e gjashtë dhe të dhjetë. ( prill 2016)
- Janë kryer takime informimi me specialistë të Ministrisë së Arsimit të Francës dhe Turqisë.
- Janë zhvilluar takime me përfaqësues të UNESCO-s dhe të ambasadës së USA në Tiranë, për të siguruar mbështetje në fushën e trajnimit të mësuesve dhe të stafit mësimor në lidhje me çështje që shoqërojnë integrimin e njohurive për fenë në shkollë.
- U zhvillua seminari 5 ditor në periudhën 17-21 tetor 2016 me mësuesit e shkollave pilot, të përcaktuara nga MAS për pilotimin e programit që lidhet me integrimin e njohurive për fenë në kurrikul. Ky seminar u bë me mbështetjen financiare dhe burimore të UNESCO. Seminari kishte si temë kryesore luftën kundër ekstremizmit dhe trajnimin e mësuesve në funksion të luftës kundër tij në edukim. Edukimi ndërkulturor ishte boshti i aftësisë të mësuesve në trajnim. Në të njëjtën kohë, mësuesit u trajnuan për integrimin e çështjeve që lidhen me fenë në kurrikulën e lëndës së qytetarisë në klasën e gjashtë (kapitulli kushtuar kulturës) dhe në klasën e dhjetë (kapitujt kushtuar: ligjit, kushtetutës, të drejtave të njeriut, arsimit etj.).
- Në datat 2-4 nëntor 2016, u zhvillua një seminar i dytë me të njëjtin grup mësuesish, i financuar nga Këshilli i Evropës. Tema kryesore e seminarit ishte edukimi për mirëkuptim ndërkulturor dhe ndërfaqësor. Vlera e shtuar e këtij seminari ishte trajtimi më i zgjeruar i koncepteve kryesore që lidhen me edukimin ndërkulturor dhe ndërfaqësor, si dhe ato që lidhen me punën e mësuesit dhe të shkollës për të krijuar një mjedis të sigurtë të edukimit qytetar në përgjithësi dhe të atij ndërkulturor e ndërfaqësor në mënyrë të veçantë.

## 2. Zhvillimi profesional i mësuesve

### 2.1 Trajnimi i mësuesve

Në bazë të planifikimit të vënies në jetë të kurrikulës së reformuar, në shtator të vitit 2015 u planifikua të zbatohet kurrikula e klasës së parë dhe të gjashtë, *e pilotuar, e përmirësuar dhe e miratuar nga MAS.*

Në zbatim të këtij plani dhe duke u mbështetur nga gjetjet e përfundimet e procesit të pilotimit në lidhje me nevojat për trajnim të mësuesve, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, gjatë periudhës maj – korrik 2015 dhe maj – korrik 2016, u angazhua për trajnimin e mësuesve (të klasave të para, të dyta, të gjashta, të shtata dhe të dhjeta të të gjitha lëndëve) dhe drejtuesve të shkollave të arsimit parauniversitar në dy nivelet AMU dhe AML, për zbatimin me cilësi të kurrikulës së re. Trajnim i veçantë u realizua me mësuesit e klasave të dhjeta, drejtuesit e shkollave dhe specialistët e kurrikulës të DAR/ZA-ve **në fund të nëntorit dhe fillim të dhjetorit 2016.**

Në kuadër të këtij procesi:

- U përgatit udhëzuesi **“Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit”** për klasat I,II,VI dhe VII.
- U përgatitën dokumentet e “Niveleve të arritjes së nxënësve”.
- U përgatit udhëzuesi **“Për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit”**
- U përgatitën **modulet e trajnimit** për secilën lëndë.
  - Modulet përfshijnë këto shtylla kryesore:
    - kompetenca dhe të mësuarit e bazuar në kompetenca;
    - zbatimin e programeve mësimore në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësit;
    - planifikimi dhe metodologjitë e mësimdhënies;
    - vlerësimi i nxënësve.
- U përgatitën **15 video informuese** shoqëruese.
- U identifikuan dhe u përzgjedhën, në bashkëpunim me DAR/ZA- të, rreth **1100** mësues, të cilët u trajnuan për të qenë **bashkëtrajnerë** me specialistët e IZHA-s në seancat trajnuese për mësuesit e klasave të para dhe të gjashta në çdo DAR.
- Gjatë muajve qershor-korrik 2015, në **13 DAR, në 26 ditë pune** u realizua **trajnimi dy ditor ( për çdo DAR) i rreth 12.500 mësuesve dhe në muajt maj – korrik 2016 i**

**rreth 12.000 mësuesve** të klasave të para, të dyta, të gjashta , të shtata dhe të dhjeta për të gjitha lëndët.

- Gjatë muajit **maj 2016** u trajnuan **400 drejtues** të shkollave të mesme lidhur me zbatimin e kurrikulës së re.
- U krijua, në secilën DAR/ZA, **databaza për mësuesit dhe drejtuesit** e trajnuar, e cila do të përdoret për certifikimin e mësuesve që morën pjesë në trajnime.
- Gjatë periudhës **shtator 2015, u trajnuan rreth 500 mësues** për zbatimin e teksteve të reja të shkencave të natyrës Fizzikë, Biologji dhe Matematikë.
- U vunë në dispozicion të mësuesve dhe përdoruesve të tjerë, në faqen e internetit të IZHA-s, të gjitha materialeve e trajnimit dhe ato që i shërbejnë zbatimit të kurrikulës.
- **Në dyjavorin e dytë të muajit nëntor 2016 dhe javën e parë të dhjetorit** të këtij viti u trajnuan **2910 mësues** të klasave të dhjeta , drejtues shkollash dhe specialistë të kurrikulës në DAR/ZA për probleme të zbatimit të udhëzuesit “Për zhvillimin e kurrikulës së re të gjimnazit” me fokus planifikimin dhe vlerësimin.

## **2.2 Kualifikimi i mësuesve**

Kualifikimi i mësuesve është proces i përvitshëm, i cili organizohet për mësuesit që plotësojnë vjetërsinë 5, 10 dhe 20 vjet punë dhe që kanë të drejtë të përfitojnë shkallët e kualifikimit:

1. Mësues Mjeshtër (kategoria I)
2. Mësues Specialist (kategoria II)
3. Mësues i Kualifikuar (kategoria III)

Në procesin e kualifikimit për vitin **2014** aplikuan **3151 mësues** të të gjitha cikleve dhe drejtues të shkollave të arsimit parauniversitar, në vitin **2015 aplikuan 3452 mësues**, ndërsa në vitin **2016 aplikuan 2950 mësues**.

Puna për realizimin e kualifikimit të mësuesve përfshiu veprimtaritë e mëposhtme:

- Hartimi i udhëzimit të kualifikimit të mësuesve **2014, 2015 dhe 2016**.
- Hartimi në total i **56 programeve të kualifikimit të mësuesve** sipas profileve përkatëse.
- Realizimi i **4 seancave** informuese me drejtues dhe përgjegjës sektori të DAR/ZA-ve për procedurat e realizimit të kualifikimit.
- Krijimi i databazës së të dhënave të mbi **9000 pjesëmarrësve** në procesin e kualifikimit për 13 DAR-e dhe 25 ZA në tre vite, **2014, 2015, 2016**.

- Hartimi i **42 testeve** të profileve të ndryshme për secilin vit. (**totali 126 teste**)
- Vlerësimi i **3151 mësuesve** në vitin 2014, **3452 mësuesve** në vitin 2015 dhe **2950 mësuesve** në vitin 2016 mbi bazën e arritjeve në teste. Vlerësimi i mbi **9000 testeve** u mundësua përmes angazhimit të rreth **100 mësuesve** të përzgjedhur si vlerësues.
- Certifikimi i mbi **9000 mësuesve** dhe drejtuesve të të gjitha lëndëve në arsimin parauniversitar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

### **2.3 Akreditimi i programeve dhe i moduleve të trajnimit**

**Gjatë vitit 2014** u ngrit për herë të dytë Komisioni i Akreditimit të Programeve të Trajnimit (KAT) bazuar në udhëzimin nr. 26 datë 15.08.2014 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”, i ndryshuar dhe në urdhrin nr. 427 datë 31.10.2014 të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Komisioni i përbërë nga përfaqësues të IZHA-s dhe institucioneve të MAS –it gjatë periudhës 2014-2015 ka kryer këto veprimtari:

- **u zhvilluan katër takime të komisionit** gjatë periudhës dhjetor 2014 – mars 2015;
- **u përgatit draft udhëzimi** “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”;
- **u hartua databaza për 369 programe/module** që funksionojnë në treg dhe janë akredituar para vitit 2013;
- **u realizua vlerësimi** i punës së **51 agjencive trajnuese** që operojnë në treg prej 3 vjetësh gjatë periudhës dhjetor 2014 – mars 2015;
- nga raporti i numrit të mësuesve të trajnuar nga agjensitë e akredituara rezulton se gjatë periudhës **2012 -2014 janë trajnuar 27 000 mësues** për module të akredituara nga agjenci të ndryshme;
- po punohet për implementimin dhe zbatimin e **Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.421, datë 04.11.2015** “ Për funksionimin e agjencive trajnuese që kanë akredituar programe/ module trajnimi”

### **2.4 Vlerësimi kombëtar i mësuesve për identifikimin e nevojave për zhvillimin profesional**

Bazuar në udhëzimin **nr. 26, datë 18.08.2014** të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në



bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH) dhe DAR/ZA-të u organizua procesi i identifikimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve dhe drejtuesve, i cili u realizua në formë elektronike dhe në fletë.

Identifikimi i nevojave për trajnim të punonjësve arsimorë në nivel mësuesi, shkolle, DAR/ZA-je, si dhe në nivel kombëtar krijoi një pamje të qartë për fushat dhe çështjet më të domosdoshme që duhet të trajtohen me prioritet, si nga institucionet e nivelit qendror ashtu edhe nga shkollat apo edhe nga vetë mësuesit. Bazuar në rezultatet e këtij procesi, drejtuesit, në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe politikëbërjes, do të hartojnë strategji dhe plane veprimi për përmirësimin dhe për zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe të aftësive të punonjësve arsimorë. Gjetjet e këtij procesi janë bazuar në rezultatet e arritura nga gjithë punonjësit arsimorë që morën pjesë në proces ( **17613 mësues dhe drejtues**).

Veprimtaritë e organizuara në kuadër të këtij objektivi renditen si më poshtë:

- hartimi i udhëzimit të identifikimit të nevojave për zhvillim profesional;
- hartimi i instrumentit të identifikimit të nevojave për trajnim të mësuesve;
- hartimi i fondit të kërkesave (**600 kërkesa**) për katër fushat e përcaktuara në udhëzim;
- takime me drejtues të RASH-it lidhur me kriteret e instrumentit dhe ndërtimin e databazës.
- realizimi i seancave informuese me drejtues dhe përgjegjës sektori të DAR/ZA-ve mbi procedurat e realizimit të këtij procesi;
- hartimi i raportit të vlerësimit të nevojave për **1651 mësues** dhe drejtues të DAR-it Tiranë;
- hartimi i **17 paketave** të instrumenteve;
- faqosja, shumëfishimi dhe paketimi i instrumenteve sipas sallave;
- përgatitja e materialeve që do të përdoren ditën e zhvillimit të procesit si: listat e pjesëmarrësve, paketat e instrumenteve për secilin mjedis, lista e sekretimit, proces verbal të cilat u administruan nga përgjegjësit e administrimit etj;
- procesi u monitorua nga përfaqësues të MAS-it dhe ISHA-s;
- hartimi i raportit të identifikimit të nevojave për zhvillim profesional;
- organizimi i konferencës për publikimin e këtij raporti.

### **3. Testimi kombëtar “Mësues për Shqipërinë”**

Testimi kombëtar “Mësues për Shqipërinë” shërbeu për të lehtësuar procesin e zëvendësimit të mësuesve pa arsimin e duhur, me mësues me arsimin përkatës, të rekrutuar mbi bazën e meritës, konkurrencës dhe transparencës. Ky proces u realizua në dhjetor të viteve 2014 dhe 2015.

Për të realizuar këtë proces:

- u hartua **udhëzimi** për organizimin e testimit “Mësues për Shqipërinë”;
- u hartuan **25 programe** orientuese për testimin e **5271 kandidatëve në vitin 2014 dhe 3790 në vitin 2015**. Në total janë testuar **9061 kandidatë**;
- programet u publikuan në portalin e MAS-it dhe u shpërndanë në të gjitha DAR/ ZA-të;
- u krijua **portali online**, për t’u dhënë mundësi aplikimi kandidatëve për mësues brenda afatit të përcaktuar. Të dhënat e aplikantëve u verifikuan për përmbushjen e kriterëve ligjore për të qenë mësues;
- u realizuan **seanca informuese** me drejtues dhe përgjegjës sektori të DAR/ZA-ve për procedurat e realizimit të testimit;
- u përgatit **data baza për 5271 dhe 3790** kandidatë mësuesit pjesëmarrës sipas DAR-eve, profileve dhe sipas mjediseve ku do të zhvillohej provimi;
- u hartuan **25 teste** nga specialistë të IZHA-s dhe mësues të zgjedhur, sipas profileve përkatëse;
- **u vlerësuan 9061 teste nga 130 korrigjues** të certifikuar të AKP, IZHA, ISHA dhe DAR.
- vazhdon puna me përgatitjen e dokumentacionit për testimin e datës 21 janar 2017.

### **4. Hartimi i standardeve sipas profileve lëndore për mësuesit.**

Veprimtaritë e organizuara në kuadër të këtij objekti renditen si më poshtë:

- diskutimi i formatit të dokumentit;
- përcaktimi standardeve të përgjithshme të mësuesit;
- hartimi i standardeve profesionale të mësuesit sipas profileve;
- hartimi i draftit të parë të të gjithë dokumentit;
- redaktimi i parë shkencor dhe komentet përkatëse;
- redaktimi i parë letrar dhe komentet përkatëse;
- procesi ka përfunduar.

## **5. Organizimi i trajnimit të drejtuesve sipas programit të zhvillimit profesional dhe kualifikimit të drejtuesve (në proces).**

IZhA në bashkëpunim me MAS ka ndërmarrë organizimin e trajnimeve të drejtuesve për zhvillim profesional. Programi ka pikënisje bindjen se drejtimi dhe menaxhimi i institucionit arsimor nuk mund t'i lihet rastësisë. Në këtë kuadër, programi është zhvilluar që të ndihmojë pjesëmarrësit të formohen si udhëheqës dhe menaxherë efektivë të organizatave shkollore, në funksion të përmirësimit sistematik të arritjeve të nxënësve.

Veprimtaritë e organizuara janë:

- hartimi i programit të zhvillimit profesional dhe kualifikimit të drejtuesve;
- hartimi i formatit të moduleve të trajnimit;
- hartimi i moduleve përkatëse të trajnimit;
- hartimi i rregullores për zhvillim profesional dhe kualifikimin e drejtuesve;
- organizimi i trajnimeve për 193 drejtues të 4 DAR/ZA-ve (Tirana, Tirana Qark, Durrës, Elbasan).
- procesi vijon.

## **6. Përmirësimi i skemës së zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë**

Është bashkëpunuar me institucionet qendrore, njësitë arsimore vendore dhe me partnerë të tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë, për përmirësimin e skemës së zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë, për ta zhvilluar shkollën gjithnjë e më shumë në një shkollë në shërbim të komunitetit.

Në këtë kuadër është bashkëpunuar me MAS-in dhe Ministrinë e Integritit për hartimin e raportit për nënkomitetet e ECOFIN dhe INOVACIONIT 2016.

Për hartimin dhe raportimin e këtyre informacioneve:

- u punua kapitulli i zhvillimit të burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar;
- u punua kapitulli i reformës kurrikulare dhe zhvillimit të burimeve njerëzore në arsimin parauniversitar.

### Po në këtë kuadër:

- Janë hartuar standardet profesionale të mësuesit për formimin e përgjithshëm dhe standardet sipas profileve përkatëse. Nëpërmjet këtyre standardeve mësuesi kupton *vizionin e ri për mësimdhënien*, një panoramë të asaj se ku duam të shkojmë. Për të përmirësuar cilësinë e tij, mësuesi duhet të *identifikojë nevojat* e shkollës, në përgjithësi, por edhe të tij, në veçanti. Standardet përfshijnë një sërë treguesish të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, për të cilat mësuesi tregon *angazhimin* për kryerjen me sukses të rolit të tij në shkollë. Secili në punën e tij punon duke pasur parasysh disa standarde që tregojnë se sa kompetent është ai në punë. *Nivelet e performancës* tregojnë se sa një mësues i përmbush këto standarde. Mësuesi që e ka të qartë se çfarë duhet të arrijë, punon në mënyrë të vazhdueshme për rritjen dhe *zhvillimin e tij profesional*. Megjithëse mësues të ndryshëm kanë nevoja të ndryshme, përsëri ka fusha për të cilat të gjithë mësuesit e shkollës kanë nevojë për trajnime. Përmbushja e standardeve mbështet mësuesin për *progresin e tij në karrierë* dhe për kualifikimin e tij.
- Është hartuar draftudhëzimi për skemën e zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë, në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH). Në draftudhëzim synohet ngritja e portalit online për regjistrimin e agjencive të trajnimit, regjistrimin online të pjesëmarrësve në trajnim, publikimi i kalendarit të trajnimeve, përdorimi i portalit për vlerësimin online nga mësuesit për organizimin e trajnimit, cilësinë e trajnerit etj. Thelbësore në këtë proces është përfshirja e IAL-ve në procesin e zhvillimit profesional të vazhduar të punonjësve arsimorë.
- U organizua konferenca kombëtare “Sfidat në formimin fillestar dhe të vazhduar të mësuesve”. ( shih konferencat).

## II. Teknologjia në mësimdhënie

Integrimi në mënyrë efektive dhe cilësore i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në mësimdhënie, në të gjitha nivelet arsimore, përdorimi i TIK-ut për avancimin në procesin e të mësuarit, janë ndër komponentët kryesorë të veprimtarisë së IZHA-s gjatë kësaj periudhe.

IZHA, gjatë periudhës **2013-2016** ka realizuar produktet e mëposhtme:

- Hartimi i **standardeve të TIK-ut** për mësuesit e arsimit bazë dhe drejtorët e shkollave:

- standardet e TIK- ut për drejtorin e shkollës;
- standardet e mësuesit për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në shkollë në të gjitha lëndët e arsimit fillor;
- standardet e mësuesit për zbatimin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në shkollë në të gjitha lëndët e arsimit të mesëm të ulët.
- Hartimi i udhëzuesit për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë, për drejtuesit dhe mësuesit. Ky udhëzues synon t'u vijë në ndihmë drejtuesve dhe mësuesve të arsimit parauniversitar për përdorimin e TIK-ut në menaxhimin e shkollës dhe procesin mësimor, kryesisht për klasat e para , të dyta , të gjashta dhe të shtata.
- Përgatitja e moduleve për informimin e mësuesve për zbatimin e standardeve të TIK-ut në shkollë.
- Përgatitja e moduleve për trajnimin e mësuesve për kurrikulën e reformuar të TIK-ut me bazë kompetencat.
- Përgatitja e CD-ve interaktive me përmbajtjen digjitale.
- Përshtatja e orëve në sistemin e tabletave për t'u përdorur lehtësisht nga mësuesit gjatë mësimdhënies dhe nxënësit gjatë procesit të të mësuarit.
- Sigurimi i burimeve alternative të të nxënësve që nxisin kreativitetin dhe bashkëpunimin e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve.
- Hartimi i broshurës për internetin e sigurtë në shkollë.
- Hartimi i materialeve burimore në ndihmë të shkollave për implementimin e metodave interaktive në klasë.

**Për këtë janë kryer:**

- studimi dhe analiza e dokumenteve kurrikulare të sistemeve arsimore të shteteve evropiane dhe më gjerë për të parë si përdorin teknologjinë për ndërtimin e situatave të të nxënësve në orën mësimore;
- organizimi i tryezave të rrumbullakta për të diskutuar draftudhëzuesin e përgatitur;
- hartimi i udhëzuesit metodik me metoda dhe teknika interaktive që nxisin kreativitetin dhe bashkëpunimin e fëmijëve gjatë mësimdhënies dhe të nxënësve.
- Përdorimi i metodologjive dhe teknikave që mbështesin qasjen bazuar në kompetenca.

Për këtë janë kryer:

- hartimi i modulit, për përdorimin e metodave dhe teknikave që nxisin zhvillimin dhe ndërtimin e kompetencave në lëndë të ndryshme të AB (konkretisht për klasën II dhe VII të AB);
- ngritja e grupeve të punës për hartimin e modulit;
- trajnimi i mësuesve të AB dhe për përdorimin e metodave dhe teknikave që nxisin zhvillimin dhe ndërtimin e kompetencave kyçe për të nxënëit gjatë gjithë jetës.
- **Karta e performancës së shkollës.** Përgatitja e pyetësorëve për prindër/nxënës/mësues, në kuadër të plotësimit të kartës së performancës së shkollave.
- **Asistencë teknike për MAS dhe Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike.**  
**Për këtë janë kryer:**

- hartimi i modulit për orën e kodimit për nxënësit e shkëlqyer në informatikë në shkollat e arsimit bazë;
- organizimi i trajnimeve në bashkëpunim me Almooc dhe Ministrinë e Inovacionit dhe Administratës Publike, në Elbasan, Vorë, Durrës;
- organizimi i konferencës në ditën e inovacionit për orën e kodimit “Maj” pranë shkollës së Kuqe.

### III. Politikat arsimore

#### 3.1 Vlerësimi i kurrikulës së formimit të mësuesve në institucionet e arsimit të lartë përballë reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar.

##### **Veprimtaritë e organizuara:**

- Bashkëpunimi me fakultetet që përgatisin mësues. Bashkëpunimi kryesor është vendosur me fakultetin e shkencave sociale, departamenti i pedagogjisë. Në bashkëpunim me ta është mundësuar sigurimi i plan programeve të studimeve master për mësuesi në fakultete të ndryshme të vendit.
- Identifikimi i përvojave dhe prirjeve evropiane e më gjerë në reformimin e sistemit të përgatitjes fillestare të mësuesit. Kjo analizë u realizua përmes konsultimit me materiale burimore dhe studime ndërkombëtare të realizuara nga organizata të ndryshme (desk research).
- Hartimi i instrumenteve për analizën e plan programeve të grumbulluara nga fakultetet.

### **3.2 Identifikimi dhe hartimi i kompetencave profesionale të mësuesve fillestarë që përgatiten nga institucionet e arsimit të lartë.**

Hartimi i kompetencave (standardeve) të mësuesve fillestarë është një hap i rëndësishëm në sigurimin e vazhdimësisë mes formimit fillestar të mësuesve dhe atij të vazhduar. Ky dokument do të nxisë reflektimin në kurrikulën e formimit fillestar të mësuesve të çështjeve që lidhen me reformimin e kurrikulës së arsimit parauniversitar si dhe do të përafrojë kurrikulat e përgatitjes së mësuesve me fakulteteve të ndryshme në vend.

#### **Veprimtaritë e organizuara:**

- identifikimi i përvojave në vend dhe evropiane në fushën e standardeve për mësuesit fillestar;
- përgatitja e një drafti të standardeve të formimit fillestar të mësuesve.

### **3.3 Ofrimi i materialeve/moduleve për institucionet që përgatisin mësues lidhur me konceptet bazë dhe risitë e reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar.**

#### **Veprimtaritë e organizuara:**

- identifikimi i çështjeve dhe tematikave kryesore që do të përmbajë paketa e moduleve;
- hartimi i paketës së materialeve /moduleve për universitetet.

## **IV. Rritja e lidhjeve të shkollës me komunitetin – shkolla si qendër komunitare (SHQK)**

Ministria e Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me IZHA, në zbatim të programit qeveritar për arsimin dhe në **kuadër të prioriteteve** të saj për përmirësimin e cilësisë së punës dhe jetës në shkollë, ndërmori nismën **“Shkolla qendër komunitare - një shkollë miqësore për të gjithë”**.

Kjo është një nismë **promovuese dhe zhvilluese** për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Arsimi është çështje e të gjithë shoqërisë. Shkolla është vendi ku shoqëria duhet të shohë të përbushur misionin e saj për arsimimin e brezit të ri. Nga ana e saj, shkolla duhet t'i tregojë vazhdimisht shoqërisë që i shërben këtij misioni, që është pjesë e saj, jo vetëm me anë të

librave e dëftesave, por edhe përmes kthimit të saj real në një pjesë të komunitetit e në shërbim të tij. Në këtë kuadër merr jetë nisma e MAS:“**Shkolla qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë**”.

Gjatë periudhës 2013-2016, Instituti i Zhvillimit të Arsimit u angazhua në zhvillimin e një sërë veprimtarive për:

- promovimin e nismës, sensibilizimin e të gjithë aktorëve për nismën dhe misionin e saj, për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe ku bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi;
- pilotimin e nismës në disa shkolla;
- krijimin e kuadrit rregullator për funksionimin e shkollës si qendër komunitare;
- ngritjen e kapacitetit të shkollave për shndërrimin në qendra komunitare;
- njohjen dhe sensibilizimin për nismën në të gjitha nivelet shkollore dhe komunitete përmes përgatitjes së fletëve informuese, posterave, organizimit të takimeve dhe hapjes së faqeve ne internet;
- promovimin e vlerave të qasjes shkollë qendër-komunitare pranë komuniteteve të shkollave;
- promovimin e nismës mbi SHQK me të gjithë aktorët lokalë;
- koordinimin me qeverisjen vendore për promovimin e turizmit, mbrojtjen e mjedisit ;
- veprimtari ne kuadrin e gjithëpërfshirjes në arsim, me komunitetin rom, fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbim psikologjik etj.

#### **Gjatë kësaj periudhe:**

- Specialistë të IZHA-s, si pjesë e grupit të punës të ngritur nga MAS dhe në bashkëpunim me përfaqësues të organizatave partnere si UNICEF, Eorld Vision, **përgatitën dokumentin e Standardeve të SHQK**. Hartimi i standardeve të shkollës qendër komunitare synoi që shkolla shqiptare të zhvillohet e t'i përafrohet gjithnjë e më shumë një shkolle, e cila i formon dhe i përgatit me mirë fëmijët dhe nxënësit për jetën. Për më shumë se një dekadë e gjysmë në vendin tonë, nga aktorë të ndryshëm të arsimit, janë zhvilluar dhe aplikuar qasje të ndryshme në shkolla me synimin për të formësuar një shkollë më miqësore për fëmijët, më gjithëpërfshirëse dhe më miqësore edhe për komunitetin.

Ky dokument orienton **rreth 200 shkollat** pilot si dhe gjithë shkollat e vendit në arsimin parauniversitar për përmbushjen e treguesve sipas fushave të standardeve, për ndërtimin e



programeve që shkojnë në dobi të zhvillimit të shkollës dhe ndërtimit të partneritetit me prindërit dhe komunitetin.

- U mundësua **përzgjedhja e shkollave** që do të zhvilloheshin si qendra komunitare. Në vitin e parë të saj u promovua në **66 shkolla** në shkallë vendi. Në vitin e dytë dhe të tretë janë rreth **200 shkolla**. Këto shkolla u përzgjedhën mbi bazën e disa kritereve bazë, të cilat u hartuan nga IZHA dhe u shpërndanë në **37 DAR/ZA**.  
Strategjia e përdorur për përzgjedhjen e shkollave për realizimin e pilotimit të projektit **“Shkolla qendër komunitare”** do të jetë metoda e përzgjedhjes e bazuar në kritere të zbatueshmërisë në terren.
- U përgatit **“Udhëzuesi për shkollën qendër Komunitare”**, i cili synoi t’u vinte në ndihmë shkollave për ndërtimin e planeve të veprimtarive dhe zhvillimin e partneritetit me komunitetin, përmes ofrimit të modeleve dhe instrumenteve të cilët mund të përdoren dhe përshtaten nga shkollat, në varësi të kushteve konkrete dhe nevojave specifike të tyre.
- U përgatit **paketa trajnuese** për koordinatorët e SHQK në nivel shkollë dhe DAR-i, për mësuesit dhe organizmat e shkollës.
- U zhvilluan **26 trajnime** për **ngritjen e rreth 120 koordinatorëve** të shkollave qendra komunitare në nivel DAR/ZA dhe në nivel shkollë në 12 qarqe të vendit.
- U zhvilluan **26 trajnime** për **ngritjen e rreth 100 kapaciteteve të bordeve** të shkollave (prindër, mësues, nxënës, përfaqësues të tjerë të komunitetit) dhe qeverive të nxënësve të shkollave qendra komunitare në 12 qarqe të vendit.
- Është dizenuar dhe vënë në dispozicion të shkollave qendër komunitare një ëbsite përmes së cilit ato shkëmbejnë idetë dhe eksperiencat pozitive të krijuara në 2-3 vite. Ëbsite gjithashtu mbështet dhe lehtëson punën e shkollave në identifikimin e nevojave të tyre, në gjetjen e prioriteteve, në hartimin e planeve të veprimtarive dhe zbatimin e tyre.

## V. Diaspora

### 5.1 Përgatitja e kurrikulës së mësimi të gjuhës amtare dhe kulturës në diasporë në bashkëpunim me MAS dhe MASHT

Bazuar në marrëveshjen e përbashkët mes MAS dhe MASHT të Kosovës, është marrë iniciativa për bashkëpunimin e ekspertëve mes dy ministrive dhe hartimin e kurrikulës së mësimi të gjuhës amtare dhe kulturës në diasporë.

Veprimtaritë e organizuara:

- identifikimi i nevojave të diasporës në drejtim të mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës shqiptare, kjo përmes takimeve dhe konsultimeve të përbashkëta mes MAS dhe MASHT të Kosovës;
- takime periodike të grupit të punës mes MAS dhe MASHT për hartimin e kurrikulës së mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës në diasporë si dhe standardet e zhvillimit profesional të mësuesve në diasporë;
- hartimi i draftit të kurrikulës së mësimit të gjuhës amtare dhe kulturës në diasporë në bashkëpunim me MAS - it dhe MASHT të Kosovës.

## **5.2 Organizimi dhe mbështetja e organizimit të seminarit të përvitshëm me mësues nga diaspora.**

Problematikat që lidhen me mësime të mësimdhënien në diasporë, janë një nga prioritetet e punës së MAS-it si dhe një nga fushat kryesore të bashkëpunimit me MASHT të Kosovës. Në këtë kuadër, prej disa vitesh tashmë, organizohet seminari me mësues të diasporës. Ky seminar synon trajnimin dhe informimin e mësuesve në diasporë për mësime të mësimdhënien në shtetet përkatëse si dhe shkëmbimin e eksperiencave të krijuara në shtete të ndryshme.

**Veprimtaritë e organizuara:**

- bashkëpunimi me të gjithë partnerët për përgatitjen e agjendës së trajnimit me mësues të diasporës, i cili ka konsistuar kryesisht me përfaqësues të MASHT në Kosovë duke arritur bashkërisht në draftimin e një programi për seminarin treditor;
- hartimi i moduleve të trajnimit të mësuesve të diasporës me angazhimin e një pjese të specialistëve në IZHA për hartimin e moduleve të cilat prezantohen gjatë seminarit.

## **5.3 Përgatitja e modeleve të veprimtarive mësimore në ndihmë të mësuesve në diasporë.**

Për të mbështetur kurrikulën e hartuar për mësuesit në diasporë është menduar që të ofrohet një set veprimtarishë mësimore të cilat mund të shfrytëzohen nga mësuesit gjatë mësimit në diasporë.

### **Veprimtaritë e organizuara:**

- identifikimi i çështjeve dhe tematikave për të cilat do të ofrohen veprimtaritë mësimore në ndihmë të mësuesve në diasporë;
- përcaktimi i formatit të veprimtarive mësimore në ndihmë të mësuesve në diasporë;
- përgatitja e veprimtarive mësimore në ndihmë të mësuesve në diasporë.

## **VI. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe asistenca teknike**

### **6.1 Rritja e partneritetit në vendimmarrje për çështje të arsimit.**

Për herë të parë mund të thuhet se procesi i hartimit dhe i miratimit të paketës kurrikulare doli realisht përtej mureve të Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe MAS.

- Partneriteti i rëndësishëm që **ka ndikuar në vendimmarrjet në lidhje me të gjithë paketën kurrikulare**, është ai me Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë së Republikës së Kosovës, i vulosur në **marrëveshjen me MAS të nënshkruar në qershor të vitit 2014 për unifikimin e kornizës kurrikulare.**
- Partneriteti me Kosovën, në kuadrin e projektit **“Institucionalizimi i mësimin plotësues në diasporë dhe mërgatë/gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”**, filluar në vitin 2012, i ndërmarrë nga MASHT e MD e Kosovës dhe MAS i Shqipërisë, është mbështetur në nenet 2 dhe 3 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nënshkruar më 19 qershor 2008, si dhe të Protokollit të sesionit të parë të Komisionit të Përbashkët Ndërqeveritar për Bashkëpunimin Kosovë – Shqipëri, i nënshkruar më 15 mars 2013.
- IZHA ka angazhim të drejtpërdrejtë në organizimin e seminareve të diasporës së bashku me palën kosovare. Deri tani janë organizuar tre seminare të përbashkëta në të cilat morën pjesë rreth **230 mësues** të diasporës. Në qershor 2014 seminari u organizua në qytetin e Beratit, në korrik 2015 në qytetin e Pejës dhe në gusht 2016 në qytetin e Shkodrës.
- Për partneritetin me Kosovën, në kuadrin e marrëveshjes **“ Për bashkërendim institucional për avancimin dhe zhvillimin profesional të mësimit në arsimin parauniversitar”** e nënshkruar në datën 23 mars 2015 në mbledhjen e dy qeverive shqiptare dhe kosovare mes MAS dhe MASHT, IZHA është angazhuar në organizimin e moduleve të trajnimit të përbashkët të mësuesve së bashku me Institutin e Studimeve

Pedagogjike në Kosovë. Të dy institutet kanë organizuar **8 ditë pune** të përbashkëta në Shqipëri dhe Kosovë duke prodhuar module trajnimi të përbashkëta.

- Nga pikëpamja institucionale, **DAR/ZA** mbeten partnerë të drejtpërdrejtë në procesin e konsultimit dhe përmirësimit të kurrikulës së re.
- Pilotimi rriti peshën e **mësuesve** dhe **specialistëve** të arsimit në procesin e hartimit dhe përmirësimit të kurrikulës.
- Vjelja e mendimit të **prindërve**, përmes pilotimit, solli një dimension të ri në procesin e konsultimit me të interesuarit e drejtpërdrejtë për cilësinë e shërbimit arsimor që kanë të drejtë të kenë fëmijët e tyre.
- Intervistat dhe pyetësorët me **nxënësit** sollën një partner të ri në tryezën e konsultimit dhe të vendimmarrjes për kurrikulën , të interesuarin dhe përfituesin e drejtpërdrejtë të arsimit, **fëmijën**.
- Përfshirja e **universiteteve** në procesin e hartimit dhe konsultimit të kurrikulës së re është garanci shtesë për cilësinë e produktit kurrikular.
- **Partneriteti me Agjencinë Kombëtare të Provimeve (AKP)** ka qenë i rëndësishëm, veçanërisht për përgatitjen e kornizës së vlerësimit, si një dokument që përcakton në shkallë të konsiderueshme edhe vetë procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Partneriteti me AKP-në për programet orientuese të maturës shtetërore ka mundësuar ide të rëndësishme edhe për reformën e arsimit të mesëm.
- **Përfshirja e Inspektoratit Shtetëror të Arsimit (ISHA)** në procesin e reformës kurrikulare dhe në vetë procesin e pilotimit të kurrikulës së klasës së parë dhe të gjashtë e bën atë një ndër partnerët e rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes për politikën arsimore në Shqipëri.

## 6.2 Asistenca teknike pranë MAS

Gjatë periudhës 2013 – 2016, specialistë të IZHA-s kanë ofruar ekspertizën e tyre dhe janë angazhuar në grupet e punës të ngritura nga MAS, për realizimin e veprimtarive në kuadër të programeve të ndryshme. *Në funksion të përvojës së tyre, specialistët e IZHA-s janë përfshirë në grupet e punës së MAS për:*

- përgatitjen e **raportit paraprak të reformës së arsimit para-universitar**, në të cilin propozohen procedurat për zbatimin e reformës në APU, aktorët, institucionet përgjegjëse dhe kufijtë kohorë për zbatimin e saj, si edhe propozimet për ndryshimet në kuadrin ligjor për SAPU-në;

- përgatitjen e **dokumentit të strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020** dhe konsultimin e saj me grupe të ndryshme të interesit;
- përcaktimin e **kritereve të përzgjedhjes dhe standardeve të teksteve shkollorë**;
- ngritjen e rreth **150 kapaciteteve të vlerësuesve të teksteve shkollorë**;
- pjesëmarrjen për **vlerësimin e teksteve digjitale**;
- përgatitjen e platformës për **vlerësimin online të nxënësve**;
- përgatitjen e **udhëzimeve të MAS për zbatimin e reformës kurrikulare të arsimit parauniversitar**;
- përgatitjen e **udhëzimeve të MAS për fillimin e viteve shkollore 2013-2014, 2014-2015;2015-2016, 2016-2017**.
- ngritjen dhe funksionimin e **gjimnazit matematikor**.  
Në kuadër të kësaj veprimtarie:
  - ✓ është hartuar udhëzimi për ngritjen dhe funksionimin e gjimnazit matematikor;
  - ✓ është përgatitur draft-plani mësimor i gjimnazit matematikor.
- përgatitjen dhe zbatimin e **programit kombëtar për edukimin mjedisor** në arsimin e mesëm të ulët , në kuadër të Marrëveshjes së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Mjedisit për Edukimin Mjedisor (Shkurt 2014).
- monitorimin e **provimeve të përvitshme të maturës shtetërore**. Çdo vit, rreth 20 punonjës të IZHA-s angazhohen në procesin e monitorimit në të gjithë vendin;
- pjesëmarrjen e specialistëve të IZHA-s në ekipet e ndihmës e kontrollit të organizuara nga MAS-i në DAR-e/ZA dhe në drejtoritë e shkollave.
- organizimin e tre tryezave konsultative për **plotësimin e Progres Raportit** për dimensionin 1 dhe 8a të SBA, me partnerë nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Ministria e Ekonomisë dhe Turizmit dhe Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë;
- pjesëmarrjen në hartimin e **strategjisë për edukimin për sipërmarrje**;
- përgatitjen dhe hartimin e draftit të planit të veprimit për përmirësimin e cilësisë së etës për personat LGBT në Shqipëri (kapitulli edukimit);
- plotësimin e **progres-raporteve periodike** të KE-së për fushën e kurrikulës dhe zhvillimit profesional të mësueve.

### 6.3 Bashkëpunimi me institucione dhe organizata të tjera

IZHA ka një rrjet të gjerë partnerësh dhe bashkëpunëtorësh lokalë, kombëtarë, rajonalë, evropianë e më gjerë, me të cilët kryen veprimtari që ndihmojnë në realizimin edhe të synimeve të veta strategjike.

IZHA është anëtare e disa rrjeteve kombëtare dhe ndërkombëtare si CIDREE, Global Education dhe synon të përfshihet në KeyCoNet. Ajo ka disa detyra dhe përgjegjësi në rrjete, si pjesëmarrjen në projekte të përbashkëta dhe ndjekjen e takimeve dhe konferencave të përvitshme, të zhvilluara në vende anëtare të ndryshme.

Gjatë periudhës 2013-2015 janë kryer një sërë veprimtarish në bashkëpunim me:

- **UNESCO**, për dhënien e ekspertizës për reformën e arsimit parauniversitar si dhe koordinimin dhe përgatitjen e dokumentin me titull: “Educational policy review of Albania”.
- **Këshillin e Evropës**, për realizimin e dy seminareve me temë: Edukimi kundër korrupsionit përmes lëndës së qytetarisë në arsimin parauniversitar.
- **UNICEF**, për:
  - ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe drejtuesve (**rreth 26000 mësues**) për zbatimin e kurrikulës së reformuar për klasat përgatitore, të para , të dyta , të gjashta, të shtata , të dhjeta.
  - prodhimin e materialeve mbështetëse online për zbatimin e kurrikulës së reformuar për klasat përgatitore, të para dhe të gjashta;
  - reformimin e kornizës së arsimit parashkollor dhe të klasës përgatitore;
  - hartimin e standardeve të arsimit parashkollor;
  - përgatitjen e kurrikulës për klasat përgatitore;
  - përfshirjen dhe integrimin e kulturës dhe historisë Rome në kurrikulën 1-9.
- **Save the Children**, për:
  - hartimin e materialeve në ndihmë të funksionimit të shkollave si qendër komunitare;
  - ngritjen e kapaciteteve të stafëve mësimore në shkollat si qendër komunitare;
  - nxitjen dhe përmirësimin e gjithëpërfshirjes në edukim;
  - njohjen dhe sensibilizimin e shkollave në lidhje me vlerësimin përshtues.
- **SEECEL – IPA – RCC (Regional Cooperation Council)**, për:
  - organizimin e panairit “Sipërmarrja-kompetencë kyçe në arsimin e gjeneratës tjetër”, në kuadër të javës evropiane të për biznesin e vogël dhe të mesëm;
  - hartimin e moduleve dhe modaliteteve të trajnimit për edukimin për sipërmarrjen për 12 shkollat pilot;
  - hartimin e skemës dhe instrumenteve të mentorimit për edukimin për sipërmarrjen në 12 shkollat pilot;

- organizimin e trajnimit 4 ditor me mësuesit dhe drejtuesit e 12 shkollave pilot, të përfshirë në rrjetin rajonal për edukimin për sipërmarrjen.
- **Fondacionin Evropian të Trajnimit (ETF)** për hartimin e Strategjisë për Edukimin për Sipërmarrjen. Ky aktivitet kryhet në bashkëpunim me MAS, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Mirëqenies Sociale.
- **Kulturkontakt-Austria**, për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve dhe përmirësimin e punës për përgatitjen e portofolit të nxënësit në kuadrin e kurrikulës së re, të bazuar në kompetenca.
- **UNFPA**, për përgatitjen e materialeve ndihmëse për mësues për edukimin shëndetësor dhe seksual.
- **British Council** ,për hartimin e moduleve për mësuesit e anglishtes, për hartimin e materialeve mbështetëse për kurrikulën e re si dhe për trajnimi i mësuesve.
- **Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF)**, për hartimin e linjës së edukimit ekonomik sipas programit të Junior Achievement për klasat K-9.

## 7. Konferenca

Gjatë periudhës 2013-2016, IZHA ka organizuar konferenca, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, kanë qenë të lidhura ose i kanë shërbyer reformës së arsimit parauniversitar. Më poshtë po rendisim disa prej tyre:

1. Konferenca kombëtare me temë: **“Sfidat e sotme në arsim: reforma kurrikulare dhe shkolla si qendër komunitare”**. Qëllimi i konferencës ishte informimi dhe sensibilizimi i aktorëve të arsimit, bashkëpunëtorëve dhe donatorëve të ndryshëm për reformimin e kurrikulës dhe rolit të shkollës si qendër komunitare (dhjetor 2013).
2. Konferenca kombëtare me temë: **“Raport paraprak i reformës së arsimit parauniversitar”**. Konferenca u organizua në bashkëpunim me MAS –in dhe kishte për qëllimin formimin dhe sensibilizimin e aktorëve të arsimit, bashkëpunëtorëve dhe donatorëve të ndryshëm për reformën e arsimit parauniversitar (korrik 2014).
3. Konferenca kombëtare me temë: **“Reforma kurrikulare në arsimin parashkollor”**. Qëllimi i konferencës ishte informimi dhe sensibilizimi i aktorëve të arsimit, bashkëpunëtorëve dhe donatorëve të ndryshëm mbi projeksionin e reformës së arsimit parashkollor (shtator 2014).
4. Konferenca ndërkombëtare me temë: **“Hartimi i standardeve të arsimit parashkollor me ekipe multidisiplinare, për fëmijët 3-6 vjeç”**.Qëllimi i konferencës ishte promovimi

- i punës me ekspertizë ndërkombëtare në bashkëpunim me UNICEF mbi hartimin e standardeve të arsimit parashkollor (nëntor 2014).
5. Konferenca kombëtare me temë: “**Implementimi i kurrikulës së re të gjuhës angleze, nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit**”. Qëllimi i konferencës ishte demonstrimi i orëve praktike të mësimi të gjuhës angleze nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit. Konferenca u organizua në partneritet me British Council (shkurt 2015).
  6. Konferenca kombëtare me temë: “**Portofoli i të nxënit, risi e kurrikulës me kompetenca**”. Konferenca u realizua në bashkëpunim me Kulturkontakt Austria për trajnimin e **500 mësuesve të 26 shkollave pilot**, për krijimin e portofolit të të nxënit në shkollat Shqiptare (qershor 2015).
  7. **Konferencë ndërkombëtare “Për lancimin e edukimit global në Shqipëri”**, e organizuar nga IZHA në bashkëpunim dhe me nismë të Qendrës Veri-Jug të Këshillit të Evropës. Qëllimi i konferencës ishte të nxisë dhe të lehtësojë dialogun dhe bashkëpunimin e aktorëve të arsimit dhe të aktorëve të tjerë të interesuar për të hartuar një strategji kombëtare dhe një plan veprimi për zhvillimin e edukimit global në Shqipëri dhe në mënyrë të veçantë në kurrikulën e shkollës. Në konferencë mori pjesë Ministria e Arsimit Znj. Nikolla, përfaqësues të Ministrisë së jashtme, të Ministrisë së Mirëqenies dhe Rinisë, UNICEF , mësues, përfaqësues të DAR etj.( 26 tetor 2015).
  8. Konferenca ndërkombëtare “**Për formimin dhe zhvillimin profesional të mësuesve**”, e cila pati për qëllim të prezantojë modele të suksesshme dhe të propozojë rekomandime, si bazë për politikat e mëtejshme të MAS-it në përmirësimin e këtij sistemi. (mars 2016).
  9. Konferenca kombëtare “Sfidat në formimin fillestar dhe të vazhduar të mësuesve”. Synimi kryesor i kësaj konference ishte sigurimi i përshtatmërisë së kurrikulës së arsimit parauniversitar me arsimin e lartë, sigurimi i vazhdimësisë mes kurrikulës së formimit fillestar dhe asaj të vazhduar të punonjësve arsimorë si dhe përfshirja e IAL-ve në sistemin e zhvillimit profesional të vazhduar të punonjësve arsimorë. (nëntor 2016).
  10. Konferenca kombëtare “Edukimi shëndetësor me fokus edukimin seksual si aftësi për jetën” që pati në fokus dimensionin e këtij edukimi në kurrikulën e arsimit parauniversitar, problematikat dhe risitë që kanë shoqëruar zbatimin e programit. ( dhjetor 2016)



## **Studime shkencore dhe botime**

Gjatë periudhës 2013-2016, IZHA ka kryer një sërë studimesh në kuadër të reformës së arsimit para-universitar. Po ashtu, IZHA boton periodikisht dy herë në vit revistën e studimeve pedagogjike në të cilën pasqyrohen artikuj dhe studime të specialistëve të IZHA-s , të specialistëve të arsimit të lartë, por dhe të mësuesve të cilët sjellin përvojat e tyre gjatë pilotimit të kurrikulës së re, por dhe problematika të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pjesë e botimit janë dhe përvojat, risitë e zhvillimeve arsimore në vende të ndryshme evropiane e më gjerë. Më poshtë po rendisim disa prej tyre:

- 1 IZHA (2013) Studimi kombëtar: “Vlerësimi i kurrikulës ekzistuese të arsimit bazë”.
- 2 IZHA (2013) Studimi kombëtar: “Analiza krahasuese e paketës kurrikulare të Shqipërisë me vendet e tjera Evropiane”.
- 3 IZHA (2013) Studimi kombëtar: “Analiza krahasuese e paketës kurrikulare të Shqipërisë dhe Kosovës ”.
- 4 IZHA (2014) Studimi kombëtar: “ Vlerësimi i kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë”.
- 5 IZHA (2015) Studimi kombëtar: “ Rezultatet e vlerësimit të pilotimit në klasat përgatitore, të para dhe të gjashta në Shqipëri”.
- 6 IZHA ( 2016) Raport kombëtar “Identifikimi i nevojave për trajnimin e drejtuesve dhe mësuesve të shkollave në arsimin parauniversitar”.

### **Botime**

1. IZHA (2014) Revista pedagogjike Qershor 2014 – “ RP” Education revieë, organ i IZHA. Shtëpia Botuese Albania.
2. IZHA (2014) Revista pedagogjike Dhjetor 2014 – “ RP” Education revieë, organ i IZHA. Shtëpia Botuese Kumi.
3. IZHA ( 2014) “Reforming school as community center in Albania” published by The Norwegian Directorate for Education and Training, Norëay.
4. IZHA (2015) Revista pedagogjike Qershor 2015 – “ RP” Education revieë, organ i IZHA. Shtëpia Botuese Flesh.
5. IZHA (2015) Revista pedagogjike dhjetor 2015 – “ RP” Education revieë, organ i IZHA. Printuar Classic Print.
6. IZHA (2016) Revista pedagogjike Qershor 2016 – “ RP” Education revieë, organ i IZHA.
7. IZHA ( 2016) “ Albania: Identification of the training needs of the teachers in the preuniversity education sector” in Edgar, S, Ed succesful approaches to raising attainment and tacklinig inequity. Cidree yearbook 2016. Livingstone. Education Scotland.